

Në bazë të nenit 4 të Ligjit mbi policinë komunale („Fl. Zyrtare MZ“, nr. 57/14), nenit 20 dhe nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit mbi veprimtaritë komunale (“Fleta zyrtare e MZ”, nr 055/16, 074/16 dhe 02/18), nenit 38 paragrafi 1 pika 14 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale („Fl. Zyrtare MZ“, nr. 02/18, 34/19), nenit 26 paragrafi 1 pika 2 të Statutit të Komunës së Tuzit („Fl. Zyrtare MZ- dispozitat komunale, nr. 24/19) dhe nenit 6 të Vendimit mbi organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit („Fl. Zyrtare e MZ – dispozitat komunale“, nr.26/19) Kuvendi i Komunës së Tuzit , në seancën e mbajtur më 18.07.2019, ka sjellë:

## **VENDIM**

### **mbi Shërbimin e policisë komunale dhe inspeksionit mbikëqyrës**

#### **I DISPOZITAT E PËERGJITHSHME**

##### **Neni 1**

Me këtë Vendim përcaktohet organizimi i Shërbimit të policisë komunale dhe juridiksioni në kryerjen e punëve të inspektimit mbikëqyrës dhe mbajtjes së rendit komunal.

##### **Neni 2**

Të gjitha shprehjet të cilat përdorën në këtë Vendim për personat fizik të gjinisë mashkullore nënkuptohet edhe për gjininë femërore.

##### **Neni 3**

Të gjitha aktet lëshohen në gjuhët të cilat janë në përdorim zyrtarë në Komunën e Tuzit.

Sigurohet komunikimi i palëve me zyrtaret e policisë komunale dhe mbikëqyrjes komunale në gjuhët që janë në përdorim në Komunën e Tuzit.

#### **II Punët e shërbimit të policisë komunale**

##### **Neni 4**

Shërbimi i policisë komunale dhe mbikëqyrjes inspektuese:

- Kontrollon rendin komunal dhe kryen mbikëqyrjen inspektuese në sferat e furnizimit me ujë, filtrimin e ujërave të zeza dhe atmosferike, transportin dhe deponimin e mbeturinave tjera komunale, pastrimit publik, mirëmbajtjen e tregjeve, parqeve, dhe sipërfaqeve të tjera të gjelbra publike, ndriçimit publik, rrugëve lokale, lagjeve, shenjave të komunikacionit dhe sinjalizimit, transporti i udhëtarëve në trafikun urban të qytetit dhe jashtë qytetit, transportit auto-taksi, parkimit, mirëmbajtjes së varrezave dhe varrimit, drejtimi dhe mirëmbajtja e objekteve të tjera të ndërtimit, drejtimi dhe mirëmbajtja e pishinave, kontrollin e orarit të punës, kontrollin e zhurmës në zonat akustike, përformimit të muzikës, përdorimi i simboleve të komunës,
- Kontrollon gjendjen e objekteve komunale,
- Kontrollon ofrimin e shërbimeve komunale në përputhshmëri me kushtet e parapara,
- Kontrollon shfrytëzimin e hapësirave publike dhe të mirave në shërbim publik,
- Merr vendim për eliminimin e pa rregullsive në procedurën administrative,
- Jep padi për vepra penale të kryera, shkelje ekonomike dhe inicimin e procedurës për kundërvajtje, shqipton dhe paguan gjobat në vendngjarje për kundërvajtje të parapara me vendime dhe ligje të komunës,
- Kryen mbikëqyrjen inspektuese në sferën komunale, në sferën e rrugëve dhe komunikacionit rrugor, mirëmbajtja e zonave publike, në sferën e mbrojtjes dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe hapësirave të gjelbra, e të cilat nuk janë në kompetencën e shtetit,

- Kontrollon sferën e banimit,
- Kryen punë të besuara, largimin e automjeteve të parkuara gabimisht, dhe kontrollin e mjeteve të parkuara në hapësirat e gjelbra;
- Kryen punët e ekzekutimit të detyruar, zgjedhjeve në procesin e kontrollit inspektues,
- Bashkëpunon me organet e qeverisjes kompetente për këtë sferë në cilat i kryen mbikëqyrja inspektuese,
- Përgatit materiale informative dhe materiale të tjera gjegjëse për organet e vetëqeverisjes lokale,
- Realizon bashkëpunimin me organizatat joqeveritare në projektet e disiplinës komunale në Komunë,
- Kryen monitorimin në sferën e ndërtimit dhe rregullimit hapësinor,
- Kryen punë inspektuese dhe punë të tjera nga kompetencat e qeverisjes lokale, për të cilat është themeluar,
- Përgatit materiale informative dhe materiale tjera profesionale për Kuvendin dhe Kryetarin e Komunës,
- Kryen edhe punë të tjera nga kompetencat e Komunës në këtë lami.

Përveç punëve nga neni 1 dhe 2 i këtij paragrafit, shërbimi i policisë komunale dhe mbikëqyrjes inspektuese:

Ofron shërbime informative për qytetarët;

- Ofron ndihmë organeve kompetente të Komunës dhe shërbimeve publike kur ato organe vlerësojnë se për realizimin e vendimeve të tyre është e nevojshme ndihma e shërbimit të policisë komunale dhe mbikëqyrjes inspektuese;
- Merr pjesë në mbrojtjen dhe shpëtimin në rast të rrezikut të shkaktuar nga fatkeqësive elementare dhe fatkeqësive të tjera, kur janë të rrezikuara të mirat materiale të qytetarëve;
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe rregullore tjera.

Përveç punëve nga neni 1 dhe 2, shërbimi i policisë komunale dhe mbikëqyrjes inspektuese:

- Ofron shërbime informative qytetarëve;
- Ofron ndihmë organeve kompetente të Komunës dhe shërbimeve publike kur këto organe vlerësojnë se në realizimin e vendimeve të tyre është e nevojshme ndihma e shërbimit të policisë komunale dhe mbikëqyrjes inspektuese;
- Merr pjesë në mbrojtjen dhe shpëtimin në rast të rrezikut të shkaktuar nga fatkeqësive elementare dhe fatkeqësive tjera, kur janë të rrezikuara qytetarët dhe të mirat materiale;
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe rregullore tjera.
- Përveç punëve nga neni 1 dhe 2, shërbimi i policisë komunale dhe mbikëqyrjes inspektuese kryen mbikëqyrjen në përdorimin e simboleve të Komunës.

### **Neni 5**

Shërbimi i policisë komunale dhe mbikëqyrjes inspektuese kryen punët të cilat janë të rregulluara me ligj për policinë Komunale dhe ligjin për mbikëqyrjen inspektuese, rregulloreve dhe akteve tjera të Komunës në at mënyrë që të sigurohet kryerja e punëve sipas ligjit në mënyrën më efikase dhe ekonomike.

### **Neni 6**

Punët e shërbimit komunal dhe mbikëqyrjes inspektuese kryhen në suazat e njëjësive të brendshme organizative.

### **Neni 7**

Organizimi i brendshëm i shërbimit të policisë Komunale bazohet në parimet:

- Kryerjes së punëve në përputhje me ligjin dhe ën mënyrë sa më efikase,
- Grupimin e punëve të përbashkëta të ngjashme,
- Zbatimin e metodave bashkëkohore dhe mjeteve teknike,
- Kontrollit të vazhdueshëm dhe përgjegjësisë në kryerjen e shërbimit

### **III ORGANIZIMI I BRËNSHËM I NJËSISË**

Organizimi i brendshëm i njësisë detajisht definohet me rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm.

### **IV FUSHVEPRIMI I PUNËS**

#### **Neni 8**

#### **1) Sektori i policisë komunale**

Në këtë sektor kryhen punës të cilat kanë të bëjnë me:

- Grupin operativ dhe kontrollues të punëve si në dalje ashtu edhe në bashkëpunim me inspektorët me qëllim të mbajtjes dhe sigurimit të rendit komunal në territorin e Komunës së Tuzit;
- Kryerjen e mbikëqyrjes komunale edhe në sfera tjera në të cilat Komuna kryen punët e saja ose punët nga kompetenca e qeverisjes shtetërore të cilat janë të përcjella me ligj ose të besuara në bazë të ligjit;
- Bashkëpunimi me organet shtetërore përmes sqarimit të ndërsjellë, ndërrimin e informatave, ofrimin e ndihmës së drejtpërdrejtë dhe ndërmarrjen e masave të përbashkëta dhe aktiviteteve me rëndësi për kryerjen e punëve të policisë komunale dhe organeve shtetërore;
- Ndihma në realizimin e organeve kompetente të Komunës dhe shërbimeve publike;
- Pjesëmarrja në mbrojtjen dhe shpëtimin në raste të rrezikut të shkaktuara nga fatkeqësitë elementare ose fatkeqësitë tjera me të cilat rrezikohen qytetarët ose të mirat materiale të tyre;
- Ofrimi i shërbimeve informative qytetarëve në teren, si dhe kryerja e punëve tjera me urdhër të kryeshefit;

#### **2) Sektori për mbikëqyrje inspektuese**

Në këtë sektor kryhen punët të cilat kanë të bëjnë me:

- Mirëmbajtja e higjienës komunale, veçanërisht kontrolli i mbajtjes ose transportit të mbeturinave si dhe pastrimi i hapësirës rreth kontejnerëve (kazanëve të plehrave) dhe dinamikave të eliminimit të tyre;
- Qasja në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit pa lejen e organit kompetent;
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik;
- Mirëmbajtja e tregjeve;
- Mirëmbajtja e objekteve komunale;
- Mirëmbajtja e varrezave dhe varrimeve
- Instalimi dhe punimi i objekteve të përkohshëm në truallin privat;
- Instalimi i objekteve të përkohshme në truallin për ndërtim;
- Instalimi i objekteve ndihmëse;
- Leja për vendosjen e stendave reklamuese – tabelave, billbordeve, shtizave në territorin e Komunës së Tuzit;
- Mbledhja dhe transporti i ujërave atmosferike;
- Transporti dhe pastrimi i ujërave të zeza;
- Parkimi i automjetit në hapësira publike (rrugëve, trotuareve, rrugëve për këmbësorë dhe biçiklist, etj), në të cilat nuk lejohet parkimi dhe ndalimi i automjeteve, si dhe hapësirat publike të gjelbra (parqet, pyjet, gjelbërimet, etj);
- Zbatimi i vendimit për orarin e punës;
- Mbrojtja nga zhurma në mjedisin jetësor;
- Sfera e banimit;
- Shitja e mallit në sipërfaqet publike, si dhe para punëtorive tregtare dhe të ngjashme pa lejen e organit kompetent;

- Kontrollin dhe lejimin për instalimin e objekteve të përkohshme të karakterit sezonal (shtandeve, tezgaqe, kiosqe, stande shite-publikuese, konservatore, frigoriferë, etj);
- Organizimin e terrasave para objekteve hoteliere;
- Deponimi i mbeturinave dhe materialeve tjera në sipërfaqet publike, sipërfaqet publike të gjelbra dhe rripit mbrojtës pranë rrugëve;
- Kontrolli, mënyra dhe kushtet e mbajtjes së kafshëve shtëpiake;
- Mbrojtja e gjelbërimit dhe sipërfaqeve të gjelbra;
- Mirëmbajtja e transportit publik të udhëtarëve në komunikacionin e trafikut urban dhe jashtë urban;
- Stacione të autobusëve, vendqëndrimin e autobusëve, rëndin e udhëtimit;
- Lejimin për realizimin dhe veprimtarinë e transportit;
- Kryerjen e veprimtarisë së auto transportit të udhëtarëve;
- Vendqëndrimet dhe stacionet e taksive, rëndin në to dhe respektimin e prioriteteve në të njëjtat;
- Lejimi për kryerjen e veprimtarisë së auto transportit të udhëtarëve;
- Siguria dhe kyçja e taksimetrit, certifikatës nga tarifa, kontrollit periodik të automjeteve, pajisjet në automjet, theksimi i firmave, marrja e udhëtarëve në stacionet dhe vendndalimet e autobusëve;
- Marrjen e udhëtarëve në stacionet dhe vendqëndrimet e autobusëve;
- Transporti i mallrave dhe objekteve;
- Lejimi për kryerjen e veprimtarisë së transportit të mallrave dhe sendeve, parkimin;
- Kryerjen e punëve të besuara nga qeverisja shtetërore, nga kompetencat e administratës së policisë sipas ligjit të besimit të një pjese të punës të administratës së policisë së kryeqendrës së Cetinjes, të Komunave Tivar, Budvë, Tivat, Kotor, Nikshiq dhe Tuz „fleta zyrtare e Malit të Zi“, numër 07/13, 32/13.
- Rrugëve lokale dhe të pa kategorizuara;
- Shenjat e komunikacionit dhe sinjalizimi, kontrolli i kushteve teknik të komunikacionit të kushteve të rrugës; sinjalizimi vertikal dhe horizontal;
- Punë dhe detyra të tjera nga kompetencat e policisë komunale përgjegjëse për komunikacion rrugor dhe rrugë lokale,
- Puna sipas kërkesave të palëve;
- Kryerja e punëve të tjera nga lëmia e veprimtarisë komunale në përputhshmëri me ligjin dhe mbikëqyrjen inspektuese, ligjit mbi turizmin dhe hotelieri, vendimin e policisë komunale dhe rregulloret e veçanta.

### **3) Reparti për punë juridike dhe administrativo-teknike**

Në kuadër të këtij reparti kryhen punët dhe detyrat të cilat kanë të bëjnë me:

- Përgatitjen dhe normatimin e akteve të përgjithshme;
- Dhënia e këshillave juridike për rregulloret nga kompetencat e shërbimit;
- Rishikimi në ankesat e dhëna dhe dorëzimi tek administratori kryesorë;
- Dhënia e kërkesës për ngritjen e procedurës penale;
- Punimi i raporteve, programeve dhe planeve të punës së shërbimit;
- Udhëheqjen e procesit në përputhshmëri me ligjin për qasjen e lirë të informacioneve dhe udhëheqësin e shërbimit të policisë komunale;
- Hyrja, shikimi dhe kontrolli i të dhënave të kaluara në regjistrin e gjobave në të holla, evidencës për kundërvajtje.

Në përbërjen e repartit është edhe call centar e cila kryen punët që vijnë:

- Grumbullimi dhe përpunimi i informacioneve, publikimeve dhe të dhënave;
- Zbaton aplikacionin SISTEM 48;
- Koordinimin dhe veprimin operativ sipas ftesës;

- Krijimin e komunikimit me shërbimet tjera në Komunën e Tuzit dhe më gjerë;
- Udhëheqjen e evidencës së paraparë.

## **V MËNYRA E REALIZIMIT TË PUNËVE DHE DETYRAVE**

### **Neni 9**

Punët dhe detyrat nga fushëveprimi i shërbimit të policisë komunale kryhen sipas programit vjetor të punës.

Në programin e punës përcaktohet aktiviteti një vjeçar i shërbimit të policisë komunale në pajtim me detyrat dhe punët të cilat dalin nga ligji dhe rregulloret tjera nga programi i punës së Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës.

### **Neni 10**

Programin e punës së shërbimit të policisë komunale e sjell kryeshefi me pëlqim të Kryetarit të Komunës

### **Neni 11**

Për kryerjen e ndonjë pune dhe detyre më të komplikuar mund të bihet plani i veçantë operativ.

### **Neni 12**

Raportet për realizimin e programit të punës e japin koordinatori i sektorit të policisë komunale, koordinatori për sigurinë e rendit komunal, inspektori kryesor dhe udhëheqësi i repartit për punë juridike dhe administrativoteknike.

Në bazë të raportit kryeshefi përgatit raportin vjetor për punën e shërbimit të policisë komunale.

Në procesin e verifikimit të programit të punës koordinatori i repartit është i obliguar, që paraprakisht me konsultimin me ekzekutorin e punëve dhe detyrave të propozojë punët dhe detyrat konkrete, të cilat do të realizohen vitin e ardhshëm në kuadër të policisë komunale.

### **Neni 13**

Të gjithë zyrtarët dhe punonjësit e shërbimit të policisë komunale janë të detyruar që ti përmbahen planit dhe programit të punës si në realizimin e vëllimit të punëve dhe detyrave ashtu edhe në pikëpamjen e afateve të caktuara.

### **Neni 14**

Koordinatori i repartit është i obliguar që çdo ditë të kontrolloj realizimin e planit të punës dhe të ndërmarr masa për planifikimin kualitativ dhe në kohë për planifikimin e punëve dhe realizimin e tyre.

Me kërkesë të kryeshefit është i detyruar të bëj raport me shkrim për realizimin e planit dhe programit të punës për çdo kërkesë.

### **Neni 15**

Kryeshefi organizon punën e shërbimit të policisë komunale me qëllim që qytetarëve tu mundësoj mënyrën më të shpejt dhe më të lehtë të realizimit të të drejtave dhe obligimeve nga sfera e punës.

### **Neni 16**

Zyrtaret dhe punëtorët e shërbimit të policisë komunale janë të detyruar që qytetarëve, në kërkesë të tyre informatat e plota për kushtet dhe procedurën e realizimit të drejtave të veçanta dhe në kryerjen e obligimeve.

### **Neni 17**

Subjekti vëzhgues është i detyruar që:

- 1) Pjesëtarin e shërbimit ta informojë, në shikim ti jap dokumentet, të dhënat e nevojshme për realizimin e mbikëqyrjes ose ti dorëzoj të dhënat e kërkuara dhe dokumentacionet në afatin e paraparë;

- 2) Ti marr masat e urdhrit të dhëna nga ana e pjesëtarit të shërbimit, nuk kryen veprim të cilin pjesëtar i shërbimit ja ka ndaluar, të veprojnë sipas zgjedhjes përfundimtare të pjesëtarit të shërbimit, me të cilin i urdhërohet largimin e mangësive të verifikuara;
- 3) Në afatin e paraparë të njoftoj inspektorin komunal për realizimin, gjegjësisht mosrealizimin e masave të urdhëruara;
- 4) Pjesëtarit të shërbimit ti mundësojë mbikëqyrjen e pa penguar.

#### **Neni 18**

Kërkesat e qytetarëve për çështje ligjore duhet të zgjidhen në afatin e caktuar, nëse kjo nuk është e mundshme për shkaqet e tejkalimit të afatit gjithsesi duhet të njoftohet parashtruesi i kërkesës.

#### **Neni 19**

E drejtë dhe obligim, i zyrtarëve dhe punëtorëve të shërbimit të policisë komunale është që të trajnohen profesionalisht dhe të shkathtësohen në përputhshmëri me punët dhe detyrat të cilat i kryejnë, si dhe me punët të cilat dalin nga procesi i organizimit të brendshëm dhe metodave të punës.

Mbajtja dhe avancimi i profesionalizmit të policave komunal sigurohet përmes verifikimeve periodike të shkathtësisë, në periudha të rregullta dhe të jashtëzakonshme të cilat i realizon ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale.

Kontrolli i rregullt i shkathtësisë profesionale realizohet sipas kërkesës si dhe në rastet kur faktet dhe rrethanat e rastit konkret me të cilin janë tejkaluar kompetencat ose është bërë lëshim në shërbim e arsyetojnë se kjo ka ngjarë për shkak të aftësisë jo profesionale.

Kontrolli i rregullt dhe i jashtëzakonshëm i aftësisë profesionale realizohen me rregullore të paraparë për vërtetimin e aftësisë profesionale të kandidatit për polic komunal, por pa i lejuar mundësinë e dhënies së provimit rishtas dhe parashtrimit të ankesave në vlerësimin e komisionit kontrollues.

Polici komunal i cili nuk merr notë pozitive nuk mund të vazhdojë të kryej punët e policit komunal dhe ti realizojë të drejtat e përcaktuara me ligj për polici komunal: përcaktohet në një vend të punës jashtë policisë komunale, punë e cila i përgjigjet përgatitjes së tij profesionale, e nëse një vend i tillë punë nuk ekziston ose polici komunal nuk pajtohet me të i ndërpritet marrëdhënia e punës me fuqinë e ligjit.

### **VI UDHËHEQJA DHE PËRGJEGJËSITË**

#### **Neni 20**

Me punët e shërbimit të policisë komunale udhëheq kryeshefi.

Kryeshefi në përputhshmëri me ligjin organizon punën dhe siguron kryerjen e punimeve ligjore efikase dhe ekonomike, angazhohet për punë transparente dhe publike, realizimin e standardeve, sjelljen me qytetarët, krijimin e standardeve të sjelljes me qytetarë dhe bashkëpunimin me ndërmarrjet e tjera publike, merr vendime për të cilat është i autorizuar, jep këshilla për kryerjen e punëve si dhe ushtron edhe punë të tjera.

#### **Neni 21**

Aktet e përgjithshme dhe individuale nga kompetencat e shërbimit të policisë komunale i nënshkruan kryeshefi.

Kryeshefi mundet me një akt të veçantë të obligojë zyrtarin tjetër për nënshkrimin e akteve të shërbimit të policisë komunale.

#### **Neni 22**

Punët e sektorit për sigurimin e rendit komunal drejtpërdrejt e udhëheq kryeshefi i policisë komunale.

Punët e sektorit për mbikëqyrje inspektuese i udhëheq koordinatori i repartit i cili drejtpërsëdrejti i jep përgjegjësi kryeshefit.

Koordinatori i repartit i përmbledh dhe e drejton punën e kryetarëve gjegjësisht punëtorëve dhe punën e njësive administrative në të cilën udhëheq i jep përgjegjësi kryeshefit.



Për studimin e pyetjeve specifike dhe realizmin e punëve dhe detyrave më të komplikuar të cilat kërkojnë punë të përbashkët dhe koordinim të njësive organizative, mund të trajnohet komisioni ekspert ose grupi punues.

Në shërbimin e policisë komunale edukohet edhe kolegji.

Kolegji është trup ekspert konsultativ të cilin e përbëjnë: kryeshefi, koordinatori i repartit si dhe këshilltari i pavarur për procedurat administrative dhe punët juridike.

Kolegji takohet një herë në javë ose sipas kërkesës, kur kryeshefi ta caktoj.

### **Neni 23**

Kolegji shqyrton të gjitha çështjet organizative dhe çështjet tjera të shërbimit të policisë komunale.

Përbërjen, mënyrën e punës të komisioneve eksperte dhe grupeve punuese i përcakton kryeshefi me vendim për arsimimin e tyre.

### **Neni 24**

Kryeshefit të shërbimit të policisë komunale në kryerjen e punëve i ndihmon koordinatori i repartit dhe këshilltari për procedurat administrative dhe punët juridike.

## **VII Shenjat zyrtare**

### **Neni 25**

Shenjat në uniformat e pjesëtarëve të shërbimit të Policisë komunale janë për:

1) Për POLICIN KOMUNAL janë:

- Mbishkrimi „ KOMUNALNA POLICIJA/ POLICIJA KOMUNALE “
- Shenjat dalluese dhe pllaka me emër, mbiemër dhe titull.

Mbishkrimi „ KOMUNALNA POLICIJA/ POLICIJA KOMUNALE “ është në një rend i qëndisur me makineri qepëset me fije perit ngjyrë floriri në formën e drejtkëndëshit, dimensionit 90x20mm, e kaltër e errët, si dhe stema e komunës e dimensionit 90x55mm. Mbishkrimi dhe stema nga paragrafi i mëparshëm mbahet i qepur ose i ngjitur në shirit në pjesën e epërme, në anën e djathtë të xhakës, xhupit, këmbës verore dhe mantilit për shi.

Shenjat dalluese është në formën e mbrojtësit, dimensionit 75x55mm, me ngjyrë blu të errët, e kufizuar me fije peri në të verdhë floriri, në të cilën në mes qëndisur me makineri është stema e komunës, numri serik dhe mbishkrimi „ KOMUNALNA POLICIJA/ POLICIJA KOMUNALE “ . Shenja dalluese mbahet mbi pjesën e majtë të xhepit në uniformë.

Pllaka me emër, mbiemër dhe thirrje (funksion) është në formën e drejtkëndëshit, dimensionit 100x30mm me ngjyrë kaltër të errët në të cilën me makinë qepëse është e qëndisur me pe ngjyrë floriri në rreshtin e parë të titullit të Policisë komunal, ndërsa në rreshtin e dytë emri dhe mbiemri i tij.

Pllaka mbahet mbi anën e djathtë të xhepit në uniformë.

2) INSPEKTORIT KOMUNAL

- Mbishkrimi „SLUŽBA KOMUNALNE POLICIJE I INSPEKCIJSKOG NADZORA/SHËRBIMI I POLICISË KOMUNALE DHE INSPEKSIONIT MBIKQYRËS“
- Shenja dalluese dhe
- Pllaka me emër, mbiemër dhe titull.
- Mbishkrimi „SLUŽBA KOMUNALNE POLICIJE I INSPEKCIJSKOG NADZORA/SHËRBIMI I POLICISË KOMUNALE DHE INSPEKSIONIT MBIKQYRËS“ është në një rresht i qëndisur me makinë qepëse me perin ngjyrë floriri në bazën me formë drejtkëndëshi, dimensionit 90x20mm, ngjyrë kaltër e errët si dhe Stema e Komunës e dimensionit 99x55mm. Mbishkrimi dhe Stema nga

paragrafi i mëparshëm i qepur ose i ngjitur me shirit në pjesën e epërme të dorës së djathtë të xhaketës, palltos, këmishës verore, etj.

Shenja dalluese është në formën e dimensionit mbrojtës 75x55mm me ngjyrë të kaltër të errët e rrethuar me ngjyrë të verdhë floriri në të cilën në mes është Stema e komunës, numri serik dhe mbishkrimi „KOMUNALNA INSPEKCIJA, INSPEKSIONI MBIKQYRËS“

Pllaka me emër, mbiemër, thirrje (funksion) është në formën e drejtkëndëshit, dimensionit 100x30mm, ngjyrë argjendi të bardhë në të cilën me shkronja të zeza në rreshtin e parë shkruhet inspektori komunal ndërsa në pjesën tjetër emri dhe mbiemri i tij. Pllaka mbahet në pjesën e epërme të xhepit të djathtë në uniformë.

3) Pjesëtarët e repartit për punë juridiko-teknike dhe administrativo-juridike:

- Mbishkrimi „SLUŽBA KOMUNALNE POLICIJE I INSPEKCIJSKOG NADZORA/SHËRBIMI I POLICISË KOMUNALE DHE INSPEKSIONIT MBIKQYRËS“ dhe
- Pllaka me emër, mbiemër dhe thirrje (funksion).

Mbishkrimi „SLUŽBA KOMUNALNE POLICIJE I INSPEKCIJSKOG NADZORA/SHËRBIMI I POLICISË KOMUNALE DHE INSPEKSIONIT MBIKQYRËS“ është e qëndisur në një rresht me fije për ngjyrë floriri në bazën në formë drejtkëndëshi, dimensionit 90x20mm, me ngjyrë të kaltër të errët si dhe Stema e Komunës me dimension 90x55mm.

Mbishkrimi dhe Stema nga paragrafi paraardhës mbahen të qepur ose ngjitur me shirit në pjesën e epërme të dorës së djathtë të xhaketës, palltos, këmishës verore, etj.

Pllaka me emër, mbiemër dhe thirrje (funksion) është në formë të drejtkëndëshit, dimensionit 100x30mm me ngjyrë të bardhë argjendi në të cilën me shkronja të zeza në rreshtin e parë shkruhet thirrja e zyrtarit ndërsa në rreshtin e dytë emri dhe mbiemri i tij.

Pllaka mbahet mbi pjesën e epërme të xhepit të djathtë në uniformë

## **VIII LETËRNJOFTIMI**

### **Neni 26**

Kryeshefi i Policisë komunale, Polici komunal dhe Inspektori Komunal kanë letërnjoftim zyrtar të shkruar në gjuhën zyrtare dhe gjuhën shqipe.

Kryeshefit të shërbimit të Policisë komunale letërnjoftimin zyrtarë ja jep Kryetari i Komunës.

Inspektorit Komunal letërnjoftimin zyrtarë ja jep kryeshefi i shërbimit të Policisë komunale.

### **Neni 27**

Letërnjoftimi është në formën e kartelës, dimensionit 70x90mm e cila është e vendosur në kopertinën e letërnjoftimit.

Letërnjoftimi posedon:

- Fotografinë e personit që posedon letërnjoftimin;
- Serinë dhe numrin në të cilin është lëshuar;
- Emrin, mbiemrin dhe thirrjen;
- Data e dhënies dhe vendi për Vulë dhe nënshkrim.

### **Neni 28**

Korniza e letërnjoftimit për kryeshef dhe Policin komunal është me ngjyrë të katërt e punuar në dy pjesë me lidhje të fort lëkure, ngjyrë të kaltër, të dimensionit 210x80mm.

Në pjesën e jashtme të kornizës është i shënuar emri: „SLUŽBA KOMUNALNE POLICIJE I INSPEKCIJSKOG NADZORA/SHËRBIMI I POLICISË KOMUNALE DHE INSPEKSIONIT MBIKQYRËS“,

Nën emërtim është i paraparë Stema e Komunës e nënstemë emërtimi „SLUŽBENA LEGITIMACIJA/LETËRNJOFTIMI ZYRTAR“.



Pjesa e brendshme e kornizës të letërnjoftimit zyrtar përmban:

- Shenjën dalluese dhe letërnjoftimi në formë kartelet.
- Në pjesën e pasme të letërnjoftimit zyrtar janë të shënuara: „OVLAŠĆENJ/AUTORIZIMET“ me përmbajtjen e tekstit i cili është:

„Polici komunal, shefi i njësisë rajonale, gjegjësisht Kryeshefi i Policisë komunale është i autorizuar që në pajtim me Ligjin për Policinë komunale, paralajmëron personin, jep urdhër gojor, kryen identifikimin dhe bën heqje lirie të personit i cili ka bërë shkelje ligjore ose ndonjë vepër tjetër penale, ndalon ose përkohësisht e largon automjetin nga komunikacioni, bën gjithashtu kontrollin e mjeteve, përkohësisht i konfiskon ato, kryen video survejim dhe i shfrytëzon mjetet e dhunës – forcën fizike, pendrekun dhe mjetet për arrestim“.

### **Neni 29**

Korniza e letërnjoftimit për inspektorin komunal është me ngjyrë të kaltër e punuar në dy pjesë me lidhje të fort lëkure, ngjyrë të kaltër, të dimensionit 210x80mm.

Në pjesën e jashtme të kornizës është i shënuar emri: „SLUŽBA KOMUNALNE POLICIJE I INSPEKCIJSKOG NADZORA/SHĚRBIMI I POLICISĚ KOMUNALE DHE INSPEKSIONIT MBIKQYRĚS“,

Nën emërtim është i paraparë Stema e Komunës e nënstemë emërtimi „SLUŽBENA LEGITIMACIJA/LETĚRNJOFTIMI ZYRTAR“.

Pjesa e brendshme e kornizës të letërnjoftimit zyrtar përmban:

„Poseduesi i këtij letërnjoftimi zyrtar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese ka obligime dhe autorizime të përcaktuara me ligjin për mbikëqyrjen inspektues dhe rregulloret tjera. Institucioni, personi juridik, organi shtetërorë dhe ai komunal, organi i administratës lokale, organi tjetër i organizatës, ndërmarrja afariste dhe forma tjetër e kryerjes së veprimtarisë ekonomike, personi fizik dhe subjektet tjera, janë të obliguar që poseduesit të këtij letërnjoftimi zyrtar ti mundësojë kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese“.

### **Neni 30**

Personit të cilit i skadon detyra e policit komunal ose inspektorit është i obliguar që të ja kthejë letërnjoftimin zyrtar kryeshefit të shërbimit të policisë komunale.

## **IX SHENJA DALLUESE**

### **Neni 31**

Shenja dalluese për Policinë komunal është në formë mbrojtëse, me ngjyrë të kaltër të errët, e rrethuar me ngjyrë të verdhë floriri, ku në mes është Stema e Komunës, numri serial dhe mbishkrimi „SLUŽBA KOMUNALNE POLICIJE I INSPEKCIJSKOG NADZORA/SHĚRBIMI I POLICISĚ KOMUNALE DHE INSPEKSIONIT MBIKQYRĚS“.

Shenja dalluese e Inspektorit Komunal është në formë mbrojtëse, me ngjyrë të kaltër të errët, e rrethuar me ngjyrë të verdhë floriri, ku në mes është Stema e Komunës, numri serial dhe mbishkrimi „KOMUNALNA INSPEKCIJA/INSPEKSIONI MBIKQYRĚS“.

Shenja dalluese nga paragrafi i këtij Neni vendoset mbi pjesën e majtë të xhepin në uniformë.

## **X UNIFORMAT ZYRTARE**

### **Neni 32**

Shërbimi i Policisë komunale dhe mbikëqyrjes inspektuese ka uniformë dhe shenja dalluese zyrtare. Gjatë ushtrimit të detyrës pjesëtarët e shërbimit të Policisë komunale mbaj uniformë zyrtare.

### **Neni 33**

Pjesëtarët e shërbimit të Policisë komunale kanë uniformë dimërore dhe verore.

Kryeshefi i shërbimit të Policisë komunale mban uniformë solemne e cila përbëhet nga:

Bereta, pantallonat, xhaketa dhe kollarja të gjitha në ngjyrë të kaltër të errët, këmishën në ngjyrë të bardh dhe këpucë të zeza.

Kryeshefi në uniformë mban karakteristikat zyrtare, në beret, Stemën e Komunës së Tuzit, ndërsa në kollare gjilpërën me mbishkrimin „SLUŽBA KOMUNALNE POLICIJE I INSPEKCIJSKOG NADZORA/SHĚRBIMI I POLICISĚ KOMUNALE DHE INSPEKSIONIT MBIKQYRĚS“.

Uniforma për PolicĚt komunal pĚrbĚhet nga:

- PĚr femra: bereta, xhaketa, fundi ose pantallonat, kominoshet e punĚs, xhupi, sako ose mantil shiju, tĚ gjitha nĚ ngjyrĚ tĚ kaltĚr tĚ errĚt, kĚmisha e kaltĚr e hapur dhe kĚpucĚt me ngjyrĚ tĚ zezĚ.
- PĚr meshkuj: bereta, xhaketa, pantallonat, kominoshet e punĚs, xhupi, sako ose mantil shiju, tĚ gjitha nĚ ngjyrĚ tĚ kaltĚr tĚ errĚt, kĚmisha e kaltĚr e ĉelĚt dhe kĚpucĚt me ngjyrĚ tĚ zezĚ.

Polici komunal nĚ uniformĚ mbaj karakteristikat zyrtare, ndĚrsa nĚ beret StemĚn e KomunĚs sĚ Tuzit.

Uniforma pĚr Inspektorin komunal pĚrbĚhet nga:

- PĚr femra: xhaketa, fundi ose pantallonat, kominoshet e punĚs, xhupi dhe sako tĚ gjitha nĚ ngjyrĚ tĚ kaltĚr tĚ errĚt, kollarja me ngjyrĚ tĚ kaltĚr kĚmisha e kaltĚr e ĉelĚt dhe kĚpucĚt me ngjyrĚ tĚ zezĚ,
- PĚr meshkuj: xhaketa, pantallonat, kominoshet e punĚs, xhupi dhe sako tĚ gjitha nĚ ngjyrĚ tĚ kaltĚr tĚ errĚt, kollarja me ngjyrĚ tĚ kaltĚr kĚmisha e kaltĚr e ĉelĚt dhe kĚpucĚt me ngjyrĚ tĚ zezĚ.
- Inspektori komunal nĚ uniformĚ mbajnĚ karakteristikat zyrtare, ndĚrsa nĚ kollare StemĚn e gravuar tĚ KomunĚs sĚ Tuzit.
- Uniforma pĚr tĚ punĚsuarit nĚ repartin pĚr punĚ juridike dhe administrativo teknike pĚrbĚhet nga:
- PĚr femra: xhaketa, fundi ose pantallonat, kominoshet e punĚs, xhupi dhe sako tĚ gjitha nĚ ngjyrĚ tĚ kaltĚr tĚ errĚt, kollarja me ngjyrĚ tĚ kaltĚr kĚmisha e kaltĚr e ĉelĚt dhe kĚpucĚt me ngjyrĚ tĚ zezĚ,
- PĚr meshkuj: xhaketa, pantallonat, kominoshet e punĚs, xhupi dhe sako tĚ gjitha nĚ ngjyrĚ tĚ kaltĚr tĚ errĚt, kollarja me ngjyrĚ tĚ kaltĚr kĚmisha e kaltĚr e ĉelĚt dhe kĚpucĚt me ngjyrĚ tĚ zezĚ.

Zyrtari nĚ uniformĚ mban karakteristikat zyrtare, ndĚrsa nĚ kollare tĚ gravuar StemĚn e KomunĚs sĚ Tuzit.

## **XI AUTOMJETET ZYRTRE DHE PAISJET E VEĉANTA**

### **Neni 34**

Automjetet zyrtare dhe lundruese tĚ shĚrbimit tĚ PolicisĚ komunale janĚ me ngjyrĚ tĚ bardh.

Shenjat nĚ automjetet zyrtare janĚ:

- Shiriti me ngjyrĚ tĚ kaltĚr, e rrethuar nga gjatĚsia me vij tĚ verdh me ndĚrprerje me ngjyrĚ tĚ bardh e cila ndodhet nĚ pjesĚt anĚsore tĚ automjetit;
- Shenja me vizatim tĚ StemĚs sĚ KomunĚs sĚ Tuzit nĚ anĚsoret e pjesĚs sĚ pĚrparme tĚ automjetit dhe nĚ derĚn e prapme tĚ automjetit;
- Mbishkrimin „SLUŽBA KOMUNALNE POLICIJE I INSPEKCIJSKOG NADZORA/SHĚRBIMI I POLICISĚ KOMUNALE DHE INSPEKSIONIT MBIKQYRĚS“ e shkruar me shkronja me ngjyrĚ tĚ kaltĚr pas vizatimit tĚ StemĚs sĚ KomunĚs sĚ Tuzit, nĚ lartĚsinĚ e dyerve tĚ para dhe nĚ pjesĚn e pasme pas vizatimit tĚ StemĚs sĚ KomunĚs, si dhe nĚ pjesĚn e pasme tĚ automjetit nĚn targat regjistruese gjegjĚsisht derĚs sĚ pasme tĚ automjetit;
- Kontakt telefoni i shĚrbimit tĚ PolicisĚ komunale.
- Shenjat e mjeteve lundruese janĚ:
- Shiriti me ngjyrĚ tĚ kaltĚr e rrethuar pĚr nga gjatĚsia me vi tĚ verdh e ndĚrprerĚ me vi me ngjyrĚ tĚ bardh e cila ndodhet pĚrgjatĚ pjesĚve anĚsore tĚ mjetit lundrues;
- Vizatimi i StemĚs sĚ KomunĚs sĚ Tuzit nĚ pjesĚn e pĚrparme tĚ pjesĚve anĚsore tĚ mjetit;
- Mbishkrimi „SLUŽBA KOMUNALNE POLICIJE I INSPEKCIJSKOG NADZORA/SHĚRBIMI I POLICISĚ KOMUNALE DHE INSPEKSIONIT MBIKQYRĚS“ shkruar mbas vizatimit tĚ StemĚs sĚ KomunĚs;
- Mbishkrimi me numrin e mjetit nĚ pjesĚt anĚsore.

### **Neni 35**

Pajisjet e veçanta të shërbimit të Policisë Komunale përbëhen:

- Pajisjet automjete dhe mjete lundruese;
- Pajisjet përcjellëse

Pajisjet e automjetit dhe mjeteve lundruese përbëhen nga:

- Sinjalizimi ndriçues i cili përbëhet nga drita e ndezjes me ngjyrë të verdhë;
- Aparatura e montuar për dhënien e shenjave zhurmuese në shumë tone të ndryshme në lartësi të kombinimit me mikrofon.

Aparaturat përcjellëse përbëhen:

- Radio lidhësja;
- Tabela për rregullimin e komunikacionit (tabela stop)
- Bilbili;
- Llamba baterijet;
- Pajisja foto dhe video;
- Fonometri;
- Sistemi llogaritës në paisje;
- Pajisja me rrjet si dhe aparaturat tjera komunikuese;
- Aparatura elektronike laser për matjen e largësisë;
- Dylbit;
- Aparatura e dorës GPS;
- Jeleku fluorescent;
- Rrathë për punën e natës për punë në kushtet e pamjes së kufizuar;
- Pendreku dhe mjetet për heqje lirie

## **XII MBIKQYRJA**

### **Neni 36**

Mbikëqyrjen për realizimin e këtij vendimi e kryen Kryetari i Komunës dhe administratori kryesor.

## **XIII DISPOZITAT NDËSHKIMORE**

### **Neni 37**

Me ndëshkim në të holla do të dënohen:

- Personi fizik dhe individ i përgjegjës juridik me shumë prej 30,20 euro deri 2000,00 euro,
- Sipërmarrësi në shumën prej 500,00 euro deri në 6000,00 euro.
- Personi juridik në vlerën prej 500,00 euro deri në 20000,00 euro, nëse:
  - 1) Pjesëtarit të shërbimit të Policisë komunale nuk i jep informacion, nuk ja jep në shikim dokumentet, të dhënat e nevojshme për realizimin e mbikëqyrjes ose nuk i jep të dhënat e kërkuara dhe dokumentacionit në afatin e paraparë (neni 14a, paragrafi 1, pika 1);
  - 2) Nuk i kryen masat e urdhëruara nga ana e pjesëtarit të Shërbimit të Policisë komunale; gjegjësisht nuk kryen veprimin të cilin pjesëtari i Shërbimit të Policisë komunale ja ka ndaluar ose nuk vepron sipas vendimit përfundimtar të pjesëtarit të Shërbimit të Policisë komunale të cilit i është urdhëruar heqja e mangësive të identifikuara (neni 14a, paragrafi 1, pika 2);
  - 3) Në afatin e caktuar nuk njofton Inspektorin komunal për realizimin gjegjësisht për mos realizimin e masave të urdhëruara (neni 14a, paragrafi 1, pika 3)
  - 4) Nëse pjesëtarit të Shërbimit të Policisë komunale nuk i mundësohet qasja e pa penguar për të kryer mbikëqyrjen (neni 14a, paragrafi 1, pika 4).

## **XIV RREGULLORET KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 38**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë prej ditës së publikimit në „Fletën zyrtare të Malit të Zi – dispozitat komunale“.

Numër: 02-030/19-4087

Tuz, 18.07.2019

**KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT**

**Kryetari,  
Fadil Kajoshaj**